

Kuvendi në kohën e COVID-19

Paraqitja e COVID-19 në botë në të njëjtën kohë ndikon ndaj të gjitha vendeve – ndaj shteteve të zhvilluara dhe ndaj shteteve në zhvillim e sipër siç është Republika e Maqedonisë Veriore. Gjatë ballafaqimit me krizat e tilla prioritet është lufta për ruajtje dhe mbrojtje të jetës së njeriut. Për llogari të kësaj, jo rrallë mbikëqyrja shkon në plan të dytë, pa marrë parasysh se rriten rreziqet për menaxhimin e mirë, sundimin e të drejtës dhe korrupsionin.

Në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria fiton autorizime që të sjell dekrete me fuqi ligjore. Jo rrallë, qëndron përshtypja se shtëpitë përfaqësuese, në gjendje të jashtëzakonshme, nuk punojnë për dy shkaqe: mendohet se urgjenca në gjendjen e jashtëzakonshme i bëjnë Parlamentet të ngathët dhe të panevojshëm; mendohet se transferimi i fuqisë ligjvënëse drejt asaj ekzekutive përkohësisht e shterr nevojën për kuvend. Mirëpo, këto mendime janë të pasakta.

Kuvendi ka rol qenësor, që në gjendjen e jashtëzakonshme të realizojë dy qëllime.

Qëllimi i parë është të sigurojë kontroll mbi pushtetin ekzekutiv. Proceset politike të vendimmarrjes në gjendjen e jashtëzakonshme janë të përshpejtuara në mënyrë të kuptueshme. Nga kjo vjen edhe transferimi i kompetencave ligjvënëse ndaj Qeverisë. Mirëpo, ndarja e pushtetit nuk është e shlyer në gjendjen e jashtëzakonshme. Përkundrazi, dhoma përfaqësuese dhe pushteti gjyqësor kanë rol të rëndësishëm në pengimin e tejkalimeve dhe të shkeljeve potenciale, posaçërisht duke pasur parasysh se në gjendjen e jashtëzakonshme të drejtat kufizohen, procedurat janë urgjente dhe me më pak mekanizma të instaluar të kontrollit.

Gjithsesi, Kuvendi ka themeluar trupa të pavarura dhe rregullatore të cilat në këtë gjendje të jashtëzakonshme do të mund ta bënin mbikëqyrjen. Mirëpo, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e deputetëve në mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizon qëllimin e dytë – negocimin dhe sigurimin e konsensusit midis aktorëve politik.

Situata në të cilën gjendja e jashtëzakonshme u shpall me qeveri teknike në të cilën ka përfaqësues të opozitës është ko incidencë. Në kushte të tjera, ajo mundet nuk do të jetë kështu, por do të paraqitet nevoja për një vend formal për përfshirje të opozitës. Këshilli për siguri nuk një forum i tillë ndërsa takimet e liderëve i përjashtojnë përfaqësuesit e qytetarëve nga procesi i miratimit të vendimeve dhe në një afat të gjatë kanë efekt negativ për proceset demokratike.

Nga kjo, rezulton se Kuvendi është forumi ku në gjendje të jashtëzakonshme ndërtohet konsensusi në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme përmes mundësimin që opozita ta kryejë rolin e vet mbikëqyrës, gjë e cila tërheq proces së bërjes së negociatave midis shumicës dhe opozitës për vendimet politike. Roli Kushtetues i Kuvendit nuk guxon të suspendohet për shkak të masave të jashtëzakonshme dhe me rëndësi është që deputetët të vazhdojnë me kryerjen e punës së tyre në pajtim me masat e sigurisë, ashtu siç e bëjnë kolegët e tyre nga 22 vendet evropiane.

Projekti “Bisedë për luftë kundër korrupsionit në Kuvendin” (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) Përfshin aktivitete hulumtuese përfaqësuese me qëllim parësor të përkrahjes së procesit reformues në Maqedoninë e Veriut përmes fuqizimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në raport me luftën kundër korrupsionit.

Projekti i përkrahur nga Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy – NED) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen përgjegjës është IDSCS dhe në asnjë rast nuk i reflekton pozicionet e Fondit kombëtar për demokraci (National Endowment for Democracy - NED).